



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2015/4 prot

Datë 04.09.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 849/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.09.2023, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur me mjete elektronike” me Nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt “Shërbim për monitorimin e mjedisit”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 29.08.2023 nga autoriteti kontraktor Albpetrol Sh.A.
- Autoriteti Kontraktor:** “Albpetrol Sh.A” me adresë Lagjja “29 Marsi” Patos, Selia: Rruga Fier-Patos, km i 7-të
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK me NIPT L81904506I dhe adresë Rruga dytësore “Maminas-Sukth”, km2.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit

*të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.08.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur me mjete elektronike” me Nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt “Shërbim për monitorimin e mjedisit”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 29.08.2023 nga autoriteti kontraktor Albpetrol Sh.A.

II.2. Në datën 17.08.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3364 protokolluar me nr. 2015 prot., datë 17.08.2023 e operatorit ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 6832/3 prot., datë 22.08.2023, protokolluar me tonë me nr. 2015/2 prot., datë 28.08.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik

informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK dhe ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues dhe Komisionin e Prokurimit Publik, se ka vendosur pranim të pjesshëm të ankesës.

II.6. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar si më poshtë:

**“[...] 1-Lidhur me pretendimin e ankimuesit se:**

*Në shtojcën 8 të DST 2.Kriteret e veçanta të kualifikimit*

*2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:*

*2.1.1 Licencë III.2.A lëshuar nga QKB për operatorin ekonomik për hartimin e raporteve të vlerësimit në mjedis, kryerje auditi mjedisor, veprimtari ekspertize për ndikime në mjedis. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili nga operatorët duhet të paraqesë licencën e mësipërme.*

*Argumenti jonë: ju bëjmë me dijeni se licenca që ju kërkoni III.2.A( 1+2) është hequr në bazë të ligjit nr. 128/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, Për vlerësimin e ndikimit në mjedis””, të ndryshuar”, neni 24 pika 2 dhe 5 citon: “2. të drejtën për përgatitjen e raportit paraprak dhe raportit të thelluar të VNM-së e kanë subjektet: a) personi fizik, i cili është certifikuar si ekspert nga ministri; b) personi juridik, administratori i të cilit është certifikuar si ekspert nga ministri dhe ka të punësuar me kontratë pune të paktën edhe 1 ekspert të certifikuar nga ministri.*

*5. Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie hartimin e raporteve të vnm-së për sa më sipër kërkojmë që ky specifikimet të hiqet sepse është përjashtues dhe bie ndesh me legjislacionin në fuqi dhe cenon rende konkurrencën e lire. Gjithashtu objekt i procedurës së prokurimit është shërbimi i monitorimit dhe plotësim i kushteve të lejes mjedisore, në asnjë moment në lejen e mjedisit nuk përmendet që duhet licenca III.2.A( 1+2), por vetëm që analizat të kryhen nga laborator i akredituar dhe hartimi i raporteve nga ekspert mjedisi i certifikuar.*

**Sqarojmë:**

*Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri AK ka patur si qëllim të sigurohet se ofertuesi është i licencuar në kryerjen e monitorimit të mjedisit. Në mungesë të përditësimit me ndryshimin e ligjit, vendosja e këtij kriteri nuk ka patur qëllim përjashtimin e asnjë operatori ekonomik. Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit për këtë pikë pranohet dhe AK do të bëjë korrigjimet e nevojshme me anë të një shtojce në DST.*

**2-Lidhur me pretendimin e ankimuesit se:**

*2.3.1. Punonjësit e stafit teknik duhet të jetë i certifikuar/trajnuar në fushat e mëposhtme:*

- *Të jetë i certifikuar për auditimin e efencës së energjisë në procese energjetike.*
- *Të jetë i certifikuar dhe të njohë standardet ISO 1996-2:2017 dhe ISO 9612:2009 ose të përditësuara për vlerësimin e zhurmës në mjedis dhe zhurmës në vendin e punës.*

- Të jetë i certifikuar për planet e menaxhimit të emergjencave mjedisore.
- Të jetë i certifikuar për menaxhimin e mbetjeve.
- Të jetë i certifikuar në planet e menaxhimit mjedisor dhe rehabilitimeve mjedisore.

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmime të kërkuara.

Për secilin punonjës të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet të figurojnë.

### **Sqarojmë:**

Kërkesat për punonjës të certifikuar janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a. duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Kërkesat për punonjësit e mësipërm janë hartuar duke iu referuar termave të referencës dhe kërkesave në lejet mjedisore që do të monitorohen.

### **Për kriteret e tjera**

- Të jetë i certifikuar dhe të njohë standardet ISO 1996-2:2017 dhe ISO 9612:2009 ose të përditësuara për vlerësimin e zhurmës në mjedis dhe zhurmës në vendin e punës.
- Të jetë i certifikuar për planet e menaxhimit të emergjencave mjedisore.
- Të jetë i certifikuar për menaxhimin e mbetjeve.
- Të jetë i certifikuar në planet e menaxhimit mjedisor dhe rehabilitimeve mjedisore.

AK të bëjë korrigjimet e nevojshme me anë të një shtojce në DST duke i shfuqizuar ato.

## **II.6. Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 831/2023 vendosi:**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-77341-08-11-2023, me objekt “Shërbim për monitorimin e mjedisit” me fond limit: 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol Sh.A.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **III**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për heqjen ose modifikimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapacitetin teknik” të dokumenteve të tenderit konkretisht:

2.3.3. “[...Punonjësit e stafit teknik duhet të jetë i certifikuar/trajnuar në fushat e mëposhtme:

- Të jetë i certifikuar për auditimin e efikasitetit të energjisë në procese energjetike.
- Të jetë i certifikuar dhe të njohë standardet ISO 1996-2:2017 dhe ISO 9612:2009 ose të përditësuara për vlerësimin e zhurmës në mjedis dhe zhurmës në vendin e punës.
- Të jetë i certifikuar për planet e menaxhimit të emergjencave mjedisore.
- Të jetë i certifikuar për menaxhimin e mbetjeve.
- Të jetë i certifikuar në planet e menaxhimit mjedisor dhe rehabilitimeve mjedisore.

Pranohen rastet kur një punonjes disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmimeve të kërkuara.

Për secilin punonjes të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit ne te cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet të figurojnë.

Argumentimi ynë: Kjo procedurë prokurimi ka si objekt Shërbimin e monitorimeve mjedisore për lejet e mjedisit A dhe B që disponon AK.

-Të jetë i certifikuar për auditimin e efikasitetit të energjisë në procese energjetike

Argumenti jonë: Hartimi i raportit të auditit të energjisë është pjesë e detyrimeve të lejes mjedisore. Është shërbim që kryhet me të tretë ose me individë të jashtëm me kontratë shërbimi. Nuk ka pse të jetë pjesë e stafit teknik me domosdoshmëri. Ky kriter cenon rëndë pjesëmarrjen e lirë të OE dhe konkurrencën e lirë prandaj kërkojmë që ky kriter të hiqet ose të modifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit., Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

“2.3.3.Punonjësit e stafit teknik duhet të jetë i certifikuar/trajnuar në fushat e mëposhtme:

- Të jetë i certifikuar për auditimin e efikasitetit të energjisë në procese energjetike.
- Të jetë i certifikuar dhe të njohë standardet ISO 1996-2:2017 dhe ISO 9612:2009 ose të përditësuara për vlerësimin e zhurmës në mjedis dhe zhurmës në vendin e punës.
- Të jetë i certifikuar për planet e menaxhimit të emergjencave mjedisore.
- Të jetë i certifikuar për menaxhimin e mbetjeve.
- Të jetë i certifikuar në planet e menaxhimit mjedisor dhe rehabilitimeve mjedisore.

Pranohen rastet kur një punonjes disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmimeve të kërkuara.

Për secilin punonjes të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit ne te cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet te figurojne.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër”.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e 14 operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.1.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.1.4. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.1.5. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.1.6. Në nenin 41, pika 2 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.*

III.1.7. Në nenin 17 “Audituesi energjetik” të ligjit 124/2015 “Për efencën e energjisë” parashikohet se: “1. Audituesi energjetik është një person fizik ose juridik, i licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Referuar kriterit teknik të sipërcituar “Punonjësit e stafit teknik duhet të jetë i certifikuar/trajnuar në fushat e mëposhtme: Të jetë i certifikuar për auditimin e efencës së energjisë në procese energjetike, referuar pikës 1, të nenit 17 të ligjit 124/2015 “Për efencën e energjisë”, Audituesi energjetik është një person fizik ose juridik, i licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe jo domosdoshmërisht të jetë punonjës i stafit të operatorit ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga përgjigjja e autoritetit kontaktor në lidhje me *Punonjësit e stafit teknik duhet të jetë i certifikuar/trajnuar në fushat e mëposhtme: Të jetë i certifikuar për auditimin e efencës së energjisë në procese energjetike*, KPP gjykon, se autoriteti kontaktor duhet ta rishikojë hartimin e këtij kriteri për praninë të punonjësit të stafit teknik, të pajisur me certifikatë për auditimin e efencës së energjisë, i cili mund të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar ose me kontratë shërbimi nga jashtë stafit të punësuar të operatorit ekonomik pjesëmarrës. Kjo do të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në zbatim të nenit 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”. Sa më lart, duke patur parasysh mënyrën e hartimit të kriterit dhe bazën ligjore në fuqi, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit sipas konstatimeve të mësipërme.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për heqjen ose modifikimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapacitetin teknik” të dokumenteve të tenderit konkretisht:

2.3.4. “Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën persona të kualifikuar si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) punonjës Inxhinier mjedisi.
- Të paktën 1 (një) punonjës ekspert me përvojë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Të paktën 2 (dy) punonjës kimist.
- Të paktën 2(dy) punonjës eksperte mjedisi të certifikuar.

*Për secilin specialist të paraqiten:*

- Diploma e arsimit të lartë.
- Për ekspertët e mjedisit të paraqiten certifikatat përkatëse të lëshuara nga organi kompetent.
- Listëpagessat e shoqërisë për tre muajt e fundit, në të cilat inxhinierët dhe specialistët e cituar duhet të figurojnë.
- Të paktën 1 (një) punonjës ekspert me përvojë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.
- Argumenti jonë: Ekspert të bën një certifikatë e marrë nga organet kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe në Shqipëri nuk ka një të tillë. Menaxhimi i integruar i mbetjeve është pjesë e edukimit të inxhinierit të Mjedisit (pjesë e kurrikules universitare). Një ekspert mjedisi me certifikatën e lëshuar nga Ministria e Mjedisit është i aftë të kryejë të gjitha këto shërbime konsulence që ju kërkoni si detyrim nga leja. Eksperti i mjedisit mund të ketë eksperiencë të ndryshme që vërtetohen me anë të CV por nuk ka certifikatë për këtë gjë. Kërkojmë që ky kriter të hiqet sepse është diskriminues dhe cenon konkurrencën e lirë”.

III.2.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, Kriteret e veçanta të kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka parashikuar:



”2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij te pakten persona te kualifikuar si me poshte:

- Të paktën 1 (një) punonjës Inxhinier mjedisi.
- Të paktën 1 (një) punonjës ekspert me përvojë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Të paktën 2 (dy) punonjës kimist.
- Të pakten 2(dy) punonjës eksperte mjedisi të certifikuar.

*Për secilin specialist të paraqiten:*

- Diploma e arsimit të lartë.
- Për ekspertët e mjedisit të paraqiten certifikatat përkatëse të lëshuara nga organi kompetent.
- Listëpagessat e shoqërisë për tre muajt e fundit, në të cilat inxhinierët dhe specialistët e cituar duhet të figurojnë.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër”.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e 14 operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.2.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.2.4. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti

*kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.2.5. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.2.6. Në nenin 41, pika 2 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, staf i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.*

III.2.7. Në nenin 6 “Përkufizime”, të ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e

ndikimit në mjedis” i ndryshuar, parashikohet se: *“Ekspert i certifikuar i VNM-së” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor.*

Në pikën 1, të nenin 7 “Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis”, të ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit”.*

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Referuar kriterit teknik të sipërcituar 2.3.4, në shkresën nr. 6832/3 prot., datë 22.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 2015/2 prot., datë 28.02.2023, në dërgimin e informacionit lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimesi, autoriteti kontraktor ka argumentuar, se në lidhje me *punonjës eksperte mjedisi të certifikuar*, citoj si vijon: *“konkretisht certifikata nga ana e AK është kërkuar për ekspertët e mjedisit. Ky certifikim jepet nga Ministria e Mjedisit (certifikatë për VNM)”.* Referuar dispozitave ligjore, në nenin 6 , pika 18 dhe pikën 1, të nenit 7 “Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis”, të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, ekspert i certifikuar i VNM-së” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor, si dhe projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor është përpara faktit që do të kryejë shërbime për monitorimin e mjedisit, duke matur komponentët e mjedisit në përputhje me kërkesat dhe kushtet e lejeve mjedisore përkatëse që ka listuar në termat e referencës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Gjithashtu, referuar termave të referencës, sipas përshkrimit të shërbimeve që do të kryejë operatori ekonomik fitues, nuk parashikon hartim, Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), i cili është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private. Referuar konstatimit sa më sipër të KPP-së, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa

për të hequr kriterin punonjës ekspert mjedisi të certifikuar, pasi nuk i shërben qëllimit të shërbimit për të cilin do të prokurohet.

Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor referuar edhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, si dhe kërkesave që vetë ai ka parashtruar në dokumentet standarde të tenderit, lidhur me 1 (një) punonjës ekspert me përvojë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, ka sqaruar, citoj: *“Për sa ju pretendoni për ekspert me përvojë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, nuk është kërkuar asnjë certifikim për këtë kriter por vetëm eksperiencë e cila vërtetohet nëpërmjet një letre reference ose kontratë të ngjashme nga ju si shoqëri për grumbullim/transportim mbetjesh, landfille, etje ose një certifikatë trajnimi për menaxhimin e mbetjeve. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë pikë e ka sqaruar operatorin ekonomik në mënyrë shteruese, si dhe konstatimit sa më lart shpjeguar, duhet të marrë masa për evidentimin e tyre, nëpërmjet një shtojce, sipas nenit 75 të LPP 162/2020, i cili parashikon shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”*, ka dhënë sqarime për operatorin ekonomik ankimues, lidhur me pretendimin e tij. Komisioni sjell në vëmendje, se këto sqarime duhet të publikohen në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit 2.3. të dokumenteve të tenderit, duke mos qenë dakort për sa i takon numrit për impiantet dhe makineritë, si dhe duke shfaqur pretendime mbi inxhinierin e naftës/gjeolog, KPP vëren se, *“2.3.5.Operatori ekonomik duhet të ketë gjithashtu minimalisht një Inxhinier nafte/gjeolog, i punësuar pranë operatorit ekonomik ose me kontratë shërbimi.*

*Për këtë të paraqiten:*

- *Diploma e arsimit të lartë.*
- *Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, ose kontrata e shërbimit me afat jo më të shkurtër se periudha që do të ofrohet shërbimi që prokurohet e shoqëruar me diplomën e arsimit të lartë.*

*Argumentimi jonë: Kërkesë për një inxhinier gjeolog/nafte është jashtë objektit të këtij prokurimi dhe nuk justifikon kërkesën. Objekti i prokurimit është Monitorimi mjedisor dhe detyrimet e lejes që bëhet nga laborator të akredituar nga DPA dhe/ose zyra konsulence dhe këto kërkesa cenojnë ndjeshëm konkurrencën e lirë dhe pjesëmarrjen e drejtë në prokurim”.*

III.3.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, Kriteret e veçanta të kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.5 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

*“2.3.5.Operatori ekonomik duhet të ketë gjithashtu minimalisht një Inxhinier nafte/gjeolog, i punësuar pranë operatorit ekonomik ose me kontratë shërbimi.*

*Për këtë të paraqiten:*

- *Diploma e arsimit të lartë.*
- *Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, ose kontrata e shërbimit me afat jo më të shkurtër se periudha që do të ofrohet shërbimi që prokurohet e shoqeruar me diplomën e arsimit të lartë.*

**Shenim:** *Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.*

*Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër”.*

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e 14 operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.3.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.3.4. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.3.5. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.6. Në nenin 41, pika 2 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.*

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet

dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Referuar testit të proporcionalitetit, vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Konkretisht, referuar shotjces nr, 7 “Formulari i termave të referencës”, për lejen mjedisore, autoriteti kontraktor ka kërkuar për secilën leje mjedisore tipi A dhe B që:

**“Në bazë të programit të monitorimit, sipas pikave të përcaktuara kërkohet:**

*Monitorimi i shkarkimeve në ajër, në kanalizime, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë dhe monitorimi i zhurmave dhe vibracionet, do të kryhet për të gjithë komponentët referuar Kushtit 7 “Shkarkimet”, Kushtit 9 “Zhurmat dhe Vibracionet” dhe Kushtit 11 “Monitorimi” të secilës Leje Mjedisore.*

#### **1 - Monitorimi i cilësisë së ajrit**

*Grimcat, PM10,*

*Gazet në mjedis SO<sub>2</sub>, O<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, TOC, H<sub>2</sub>S, CO.*

#### **2 - Monitorimi i cilësisë së ujërave në kanalizime dhe ujëra sipërfaqësorë.**

*Grimcat, PM10, Rrjedhja, pH, temperaturë, toksiciteti, TSS, NBO-5, NKO, COD, BOD5 Produkte nafte, Fenole volative, Sulfide, Klorure, Metale toksik (në total), Azot Amonjak N mg/l, Azot total, Fosfor total, Cd, Cr, Cr (VI), As, Pb, Hg, Zn, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.*

#### **3 - Monitorimi i ndotjes akustike**

*Zhurma në mjedis dhe në vendin e punës sipas kushteve të përcaktuara në Lejet Mjedisore.*

#### **4 – Vibrimet (matja e vibrimeve si pasojë e aktivitetit të operimit)**

*Matja e vibrimeve do të kryhet për vende të ndjeshme në mm/s (ppv).*

***Të gjitha monitorimet duhet të kryhen për secilën pikë, në përputhje me Kushtet e Lejeve Mjedisore. Marrja e mostrave dhe analizat duhet të kryhen siç përcaktohen në standardet ISO”.***

Për sa më sipër, vetë autoriteti kërkon që të bëhet monitorimi i shkarkimeve në ajër, në kanalizime, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë dhe monitorimi i zhurmave dhe vibracionet, do të kryhet për të gjithë komponentët referuar Kushteve të secilës Leje Mjedisore dhe nuk ka sqaruar në asnjë nga pikat më lart rolin apo funksionin e inxhinierit nafte/geolog (i punësuar pranë operatorit ekonomik ose me kontratë shërbimi), mbi pikat që do të monitorohen. Gjithashtu, në procesverbalin e argumentimit të kriterëve teknike të kualifikimit, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar nevojën e disponibilitetit të një inxhinier nafte/geolog, në lidhje me monitorimet që do të kryhen sipas kushteve të lejeve mjedisore.

Duke e parë në këtë këndvështrim, KPP gjykon, se vendosja e kriterit që operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një inxhinier nafte/geolog i punësuar pranë operatorit ekonomik ose me kontratë shërbimi, nuk është në përputhje me objektin e prokurimit, i cili është shërbim për monitorimin e mjedisit. Sa më lart, duke patur parasysh mënyrën e hartimit të kriterit, lejet mjedisore dhe termave të referencës të përcaktuara në shtojcën nr. 7 (Formulari i

termave të referencës), KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kriterit sipas argumentimeve të mësipërme.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur me mjete elektronike” me Nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt “Shërbim për monitorimin e mjedisit”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 29.08.2023 nga autoriteti kontraktor Albpetrol Sh.A.
  2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Fiorent Zguro</b>	<b>Kreshnik Ternova</b>	<b>Anila Malaj</b>

### Kryetar

**Jonaid Myzyri**

